

UNIVERSITETI " HAXHI ZEKA" - PEJË

Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis



PUNIM DIPLOME

Rritja dhe zhvillimi i turizmit në Rugovë

Mentori:

Prof. Dr. Bedri Millaku

Kandidatja:

Elsa Nallbani

Pejë, 2023

Punim Diplome

Lënda: Hyrje në Turizëm dhe Hotelieri

Tema: Rritja dhe zhvillimi i turizmit në Rugovë

Studenti:

Emri dhe Mbiemri: **Elsa Nallbani**

Statusi: **E rregullt**

Numri amëz: **311452018**

Departamenti: **Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis**

Shkalla e studimit: **Bachelor MTHM**

Mentori: **Prof. Asoc. Dr. Bedri Millaku**

Abstrakt

Ndër destinacionet më të reja turistike të cilat mund të hyjnë në listën e top destinacioneve kosovare, nuk mund të mos ju njohim me Bjeshkët e Rugovës, si një nga vendet më të bukura në Kosovë ku mund të përjetoni përvoja të paharrueshme mes ajrit të patër e natyrës që është treguar vërtetë bujare me këtë vend. Ju mund ta vizitoni në qdo stinë këtë krahinë të mrekullueshme, duke qenë të sigurtë për argëtimin tuaj, cili fillon me shetitjet në natyrë, me gjelbërimin marrëmendës, me ekspedita të gjata zbuluese të vendeve më të bukura, me shijimin e ushqimeve natyrale, dhe mikëpritjes së pashoqe, e përfundon me sportin e skive, që ju presin në zemër të dimrit, të rrëshqisni mbi shpatet të butë e të ashpër njekohësisht.

Rugova është një lokalitet më vete që përbëhet prej 13 fshatrave të cilat shtrihen në perëndim të qytetit të Pejës, nga të dy anët e këtij qyteti. Rugova fillon prej aty ku Bistrica e Pejës del nga Gryka e Rugovës dhe vazhdon gjatë këtij lumi deri te burimet e tij në qafë të Qakorrit në perëndim. Territori i Rugovës në kohën e sundimit osman ka qenë edhe më i gjerë. Kështu në perëndim përfshinte, malet e Smajlovicës, Glllogjinë, dhe Rekat e Shekullarit, dhe vazhdonte deri në afërsi të Tregovishtes (Rozhajës), ku përfshinte disa katunde.

Fjalët kyqe: Destinacionet turistike, Bjeshkët e Rugovës, Natyra

Me rastin e punimit të kësaj teme të diplomës dëshiroj së pari të falënderoj familjen time dhe mësime të mësimdhënësit. Mbështetja e tyre gjatë këtyre tri viteve të studimeve ka qenë e pandalshme dhe faktor kyq në përfundimin me sukses të studimeve.

Dëshiroj të falënderoj edhe shoqërinë time për përkrahjen, motivin, këshillat dhe kujtimet më të mira që mi kanë dhënë gjatë këtyre tri viteve të studimit.

Përmbajtja

1. Hyrje

1.1. Turizmi

2. Rugova

2.1. Bjeshkët e Rugovës

2.2. Aktivitetet rekreative

2.3. Qiklizmi rekreativ

2.4. Ngjitja në shkëmbinjë

2.5. Skijimi i lirë

2.6. Bjeshkataria & Alpinizmi

2.7. Apinizmi – Pushtimi i Majave

2.8. Paraglide

3. Merimangat e Pejës

3.1. Via Ferrata (Shpellat)

3.1.1. Via Ferrata Mat

3.1.2. Via Ferrata Ari

3.1.3. Via Ferrata Merimangat

4. Ura e Madhe Tibetiane

5. Zip Line

6. Veçoritë themelore dhe zhvillimi i marketingut të udhëtimeve turistike

6.1. Definimi i marketingut

6.2. Zhvillimi i marketingut

7. Kuptimi i Agjensive Turistike

8. Lugina e Rugovës

9. Vështrim në konceptet teorike të interpretimit të historisë dhe të trashigimisë kulturore

10.1. Interpretimi i historisë

11. Evoluimi i Turizmit

9. Përfundimi

10. Referencat

1. Hyrje

Turizmi si veprimtari, po merr gjithnjë përmasa më të mëdha të zhvillimit. Për shkak të nevojës që ka vendi ynë për zhvillimin ekonomik dhe numrit të konsiderueshëm të potencialeve turistike rëndësi e veçantë i është kushtuar kësaj veprimtarie.¹ Ta përshkruar Pejën dhe Rugovën, përmes një manuali do të thotë shumë më tepër se sa thjeshtë t'i ftosh turistët dhe të apasionuarit drejtë bukurive dhe veqantive të natyrës së kësaj zone. Mjafton vetëm një kalim përgjatë Grykës së Rugovës, për ta ndjerë jo vetëm bukurinë së pashoqe të saj, por edhe për ta kuptuar se kjo hapsirë fsheh ende thesare të pazbuluara nga kërrkuesit e tyre. Është Peja me Rugovën krahas bukurive dhe të papriturave të panumerta si Kanionet, Liqenet , Ujëvarat, dhe Shpellat e mrekullueshme, ka qenë edhe skena e një të kaluare mite, legjenda dhe nje trashigimi historike.²

2. Rugova

¹ F. Reçica, B. Millaku "Hyrje në turizëm dhe Hotelieri" Fq. 5 Prishtinë 2014

² <https://kk.rks-gov.net/peje/turizmi/>

Regjioni i Bjeshkëve të Rugovës, shtrihet në veriperëndim të qytetit të Pejës dhe ka sipërfaqe prej 32. 492. 96 ha, në të cilën sipërfaqe gjenden 15 fshatra dhe njëri prej regjionet malore, përfshijnë Bjeshkët e Nemuna, me pasuri më të mëdha natyrore. Pothuajse në të gjithë hapsirën e Bjeshkëve të Rugovës, mund të hasësh në mrekullitë që gjenden të fshehura nën egërsinë malore të florës. Janë liqenet madhështor që gjenden me lartësi prej 1866 m në Liqenat të Kuqishtës, dy ujëvarat në Rekën e Allagës, flora dhe fauna e shpërndarë në gjithë regjionin, bukuria e pamjeve që mund të vëzhgosh nga Bjeshkët e ndryshme etj. Në ditët e sotme ky regjion malor ka filluar të bëhet shumë atraktiv për turistët, dhe janë duke e vizituar gjithnjë e më shumë banorët e Kosovës dhe të huaj, jo vetëm për shëtitje, por edhe për të kryer aktiviteteve rekreative/sportive. Me pasuritë e mëdha që disponon, regjioni malor i Rugovës ofron mundësi të shumta për kryerjen e aktiviteteve rekreative – sportive, ku shumë dashamirë të natyrës entuziastë të bjeshkës dhe sportistë e kalojnë kohënduke shijuar ajrin e pastër, natyrën e gjallë dhe kënaqësinë epamjeve pitoreske.³

³ <https://kk.rks-gov.net/peje/turizmi/>

2.1 Bjeshkët e Rugovës

Bjeshkët në rajon janë shumë të bukura, por bjeshkët e Rugovës veçohen me karakteristikat e saja unike. Kjo trevë malore ka një potencial të papërshkrueshëm e cila ofron mundësi turistike për të gjitha moshat duke filluar nga fëmijët e deri tek të moshuarit, ka një biodiversitet që ofron mundësi për zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit dhe ka një qasje shumë të lehtë dhe njëherit, është porta kryesore hyrëse për në parkun nacional Bjeshkët e Nemuna. Dhe me të vërtet bjeshkët e Rugovës, janë parajsë natyrore të cilat në çdo stinë dhe pothuajse çdo ditë janë unike, ofrojnë pamje atraktive ndërsa shumë vizitorë të moshave të ndryshme që e vizitojnë këtë trevë malore, përjetojnë eksperiencë të shumta të cilat mbesin gjatë në memorien e tyre por edhe shumë nga kthehen që të përjetojnë prap këto bukuri natyrore. Të shquara, janë edhe Lojërat Tradicionale të Rugovës ku në të janë 5 kategori të cilat luhen, veshjet tradicionale të meshkujve dhe të femrave, pastaj Vallja e Rugovës me shpatë e cila është shumë unike, muzika folklorike dhe këngët epike historike dhe legjendare që luhen me tingujt e lahutës e cila është një instrument tradicional, muzika karakteristike me gjeth të pemës, si dhe traditat tjera që zhvillohen gjatë ceremonive të ndryshme si martesore.⁴ Kosova ka mjaftë resurse turistike që krijojnë mundësi për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit, trashigimë kulturore dhe natyrore. Bjeshkët e Rugovës janë destinacion i mrekullueshëm në çdo stinë.

Klima e Rugovës

Rugova është vend me klimë të përshtatshme për verime, me verë të freskët ku temperaturat shkojnë deri në 17.2 gradë celsius e ndonjëherë edhe

⁴ <https://kk.rks-gov.net/peje/turizmi/>

deri në 20 e 25 gradë celcius që e favorizon turizmin shtëpiak, stacionar, shërues dhe sportive recreative si: ngjitje dhe marshim, shëtitje, vizita të monumenteve kulturo historike, lëshim me parashuta, notim në Liqenin e Liqenatit dhe lundim në lumë. Dimri i ftohtë dhe i përshtatshëm favorizon zhvillimin e turizmit dimëror, skijim, ngjitje etj.

Bimët mjekuese

Në Alpet e Shqipëtarve gjenden numër i konsiderueshëm i Bimëve mjekuese. Për popullatën e regjionit të Pejës dhe më gjerë më të njohurat janë: Kantarioni, Lulja e Gjehnetit, Lule Kamamili, çaji uvin, çaji i malit etj, si dhe prodhimet frutore malore: Boronica, Dredhëza, Mjedra, Kërpurdha disa lloje, Manaferra, Thana, Lajthia etj.

Në Bjeshkët e Rugovës gjendet edhe Liqenati i cili është që është një nga bukuritë atraktive natyrore të këtij rajoni.

Fotografia e Liqenatit në Rugovë



Fotografia e parë Gryka e Rugovës

Ura e Grykës së Rugovës, është ndërtuar që nga shekulli i XVI



https://ëëë.google.com/search?q=rugova&&tbm=isch&ved=2ahUKEëilxpSdyer6AhÉE47sIHĖetCXUQ2-cCegQIABAA&oq=rugova&gs_lcp=CgNpbĖcQARgAMgQIlxAnMgUIABCABDIFCAAQgAQyBQgAEIAEMgUIABCABDIFCAAQgAQyBQgAEIAEMgUIABCABDIFCAAQgAQyBQgAEIAEUABYAGCrCĖgAcAB4AIABcYgBcZIBAzAuMZgBAKoBC2d3cy13aXotaĖ1nĖAEB&scient=img&ei=agZPY4jpGITH7_UP59qmqAc&bih=754&biĖ=1536

Fotografia e Dytë Malet e Rugovës



9

⁵ https://ëëë.google.com/search?q=rugova&&tbm=isch&ved=2ahUKEëilxpSdyer6AhÉE47sIHĖetCXUQ2-cCegQIABAA&oq=rugova&gs_lcp=CgNpbĖcQARgAMgQIlxAnMgUIABCABDIFCAAQgAQyBQgAEIAEMgUIABCABDIFCAAQgAQyBQgAEIAEMgUIABCABDIFCAAQgAQyBQgAEIAEUABYAGCrCĖgAcAB4AIABcYgBcZIBAzAuMZgBAKoBC2d3cy13aXotaĖ1nĖAEB&scient=img&ei=agZPY4jpGITH7_UP59qmqAc&bih=754&biĖ=1536

2.2. Aktivitetet rekreative

Komuna e Pejës, shtrihet në veriperëndim të Kosovës dhe radhitet ndër komunat më të mëdha të Kosovës si dhe me numër më të madh të banorëve. Gjendet në Rrafshin e Dukagjinit, dhe shtrihet rrëzë Bjeshkëve të Rugovës të cilat janë pjesë e bjeshkëve të Nemuna. Karakteristikë e këtij qyteti është afërsia dhe lehtësia e qasjes në Bjeshkët e Rugovës, e cila është vetëm 1km nga qenda e qytetit.

Është ndër komunat, e cila ka më së shumti potenciale natyrore dhe dinamike të madhe lëvizjeve të cilat i mundësojnë këtij qyteti të njihet ndryshe " Qyteti i Gjelbërt dhe Vital". Në vitin 2013, kjo komunë është shpallur edhe destinacioni premtues i Turizmit për të Nesërmen" nga ËTTC.⁶

2.3. Qiklizmi rekreativ

Peja qytet i çiklizmit siç njihet edhe ndryshe është vend i cili ofron mundësi të shumta, dhe rekreative për adhuruesit e këtij aktiviteti. Pozita e mirë e shtrirjes

⁶ <https://kk.rks-gov.net/peje/ëp-content/uploads/sites/24/2018/04/aktivitetet-rekreative.pdf>

dhe shtrirja e rrafshët e qytetit ka mundësuar që biçiklizmi, të jetë një aktivitet shume i adhuruar te banorët vendas. Tani, më janë zhvilluar edhe shtigjet e çiklizmit malor në rajonin e Rugovës, të cilat kanë vështirësi të ndryshme në bazë të aftësive fizike të adhuruesve të këtij aktiviteti. Të gjitha këto shtigje mund të përshkohen brenda ditës, ndërsa adhuruesit e natyrës mund të zgjasin qëndrimin gjegjësisht aktivitetet e tyre gjatë tërë vikendit kombinimin me këtyre shtigjeve. Po, ashtu ekzistojnë edhe shtigjet e biçiklizmit rekreativ në nivel rajonal që lidhin Pejën me vendet e tjera si: Deçanin, Junikun, Klinën dhe Istogun, të cilat kalojnë nëpër fshatrat lokale ku qarkullimi i automjeteve nuk është i madh.⁷

Fotografia e katërt Qiklizmi rekreativ



https://ëëë.google.com/search?q=ciklizmi+rekreativ&sxsrf=ALiCzsrbpuCtLkXB__aC9Ën9gBCHngpGefg:1666125025813&source=Inms&tbm=isch&sa=X&ved=2ahUKEëjVIMKyz-r6AhXdQvEDHaUbCDUQ_AUoAXoECAIQAë&bië=1536&bih=754&dpr=1.25#imgsrc=anK52gËA-G0vRM

⁷ <https://kk.rks-gov.net/peje/ëp-content/uploads/sites/24/2018/04/aktivitetet-rekreative.pdf>

⁸

https://ëëë.google.com/search?q=ciklizmi+rekreativ&sxsrf=ALiCzsrbpuCtLkXB__aC9Ën9gBCHngpGefg:1666125025813&source=Inms&tbm=isch&sa=X&ved=2ahUKEëjVIMKyz-r6AhXdQvEDHaUbCDUQ_AUoAXoECAIQAë&bië=1536&bih=754&dpr=1.25#imgsrc=anK52gËA-G0vRM

2.4. Ngjitja në shkëmbinjë

Vetëm 3 km nga qyteti i Pejës, në drejtim të Grykës së Rugovës, fillojnë shtigjet e ngjitjes. Ekzistojnë 8 zona të cilat njihen me emra të ndryshëm në regionin e Rugovës. Zonat janë lehtë të arritshme dhe përmbajnë nga 1 deri në 15 shtigje të ngjitjes, me gjatësi prej 10 deri në 280 m dhe vështirësi prej 5 deri në 8b+. Gjithësej në Rugovë, gjenden 40 shtigje të ngjitjes. Shtigjet janë të hapura në mënyrë profesionale nga ekspertë të vendit dhe Italian, kështu që siguria është në nivel dhe kontrollohen në çdo fillim të sezonës.

9

Fotografia e pestë Ngjitja në shkëmbinjë



10

https://ëëë.google.com/search?q=ngjitja+ne+shkembinj&sxsr=ALiCzsZiK0NCPr1piDkLD4f9VF_otZsëag:1669931606136&source=lnms&tbm=isch&sa=X&ved=2ahUKEëiJ_bqBtNn7AhXaR_EDHToYCFsQ_AUoAnoECAIQBA&bië=1536&bih=754&dpr=1.25#imgsrc=cqoeseVKI3irKM

12

2.5. Skijimi i lirë

⁹ <https://kk.rks-gov.net/peje/ëp-content/uploads/sites/24/2018/04/aktivitetet-rekreative.pdf>

¹⁰ https://ëëë.google.com/search?q=ngjitja+ne+shkembinj&sxsr=ALiCzsZiK0NCPr1piDkLD4f9VF_otZsëag:1669931606136&source=lnms&tbm=isch&sa=X&ved=2ahUKEëiJ_bqBtNn7AhXaR_EDHToYCFsQ_AUoAnoECAIQBA&bië=1536&bih=754&dpr=1.25#imgsrc=cqoeseVKI3irKM

Njiheshin banorët e Pejës, për garimet në ski mirëpo edhe për zhvillimin e skijimit ekstrem duke përdorur shtigje të vështira për skijim. Po, ashtu tani është qytet i cili e ka mjaft të zhvilluar këtë disiplinë rekreative – sportive. Për adhuruesit e skijimit fshati turistik Bogë, ofron mundësinë që të zhvilloni aktivitetin e adhuruar nga ju. Mu në këtë fshat gjendet shtegu i skijimit i cili ofron kushte mjaftë të mira për adhuruesit e skijimit dhe është i pajisur më skilift. Po, ashtu në këtë fshat mund të gjeni vende për akomodime me standarde mjaftë të mira dhe ushqim tradicional. Regjioni i Rugovës, ofron po ashtu mundësi për të gjithë adhuruesit e skijimit të lirë në terrene dhe shtigje të përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti.¹¹

Fotografia e gjashtë Skijimi i lirë



12

https://ëëë.google.com/search?q=skijimi+i+lire&sxsrf=ALiCzsa3ëKGdR_rCAXëlbkfnIP2KZë-YuQ:1669931964704&source=lnms&tbn=isch&sa=X&ved=2ahUKEëiOmristdn7AhVFOHoKHULëAAIQ_AUoAXoECAIQaë&bië=1536&bih=754&dpr=1.25#imgsrc=mfTvlNk5u0y-IM

¹¹ <https://kk.rks-gov.net/peje/ëp-content/uploads/sites/24/2018/04/aktivitetet-rekreative.pdf>

¹² https://ëëë.google.com/search?q=skijimi+i+lire&sxsrf=ALiCzsa3ëKGdR_rCAXëlbkfnIP2KZë-YuQ:1669931964704&source=lnms&tbn=isch&sa=X&ved=2ahUKEëiOmristdn7AhVFOHoKHULëAAIQ_AUoAXoECAIQaë&bië=1536&bih=754&dpr=1.25#imgsrc=mfTvlNk5u0y-IM

2.6. Bjeshkataria & Alpinizmi

Bjeshkataria

Bjeshkataria është aktiviteti i cili praktikohet në masë të madhe nga popullata locale, por edhe nga vizitorët e shumtë që e vizitojnë Pejën. Është pjesa e regjionit malor e Rugovës, e cila i ofron shtigjet për ecje malore të cilat janë mjetë atraktive dhe aventuriere për të gjithë adhuruesit e bjeshkatarië dhe kohës së lirë,. Shtigjet të cilat janë të punuara dhe të dizajnuara me qëllim që të ofrojnë aventura të ndryshme gjatë ecjes, të cilat kalojnë përmes bukurive të rralla të natyrës, egërisë së florës, vizitës së ujëvarave e deri tek lidhja e tyre me akomodimin dhe kulturën e traditën e vjetër të banorëve të Rugovës.

2.7. Alpinizmi – Pushtimi i Majave

Kjo është madhështia e majave, të këtij vendi natyror të quajtur Rugova. Ofron mundësi të pushtimit të këtyre majave edhe për adhuruesit e alpinizmit por edhe të rekreacionit, që dëshirojnë sfida dhe përballje me vështirësitë natyrore. Në këtë rajon gjenden, më se 19 maja të cilat kanë lartësi mbi 2000 m mirëpo ndër to që veçohen për nga karakteristikat bjeshkatore dhe alpine janë: Guri i Kuq me lartësi prej 2522 m, Maja e çfërles në lartësi prej 2461 m, maja e Hajles me lartësi prej 2403 m si dhe maja e Vjellakut në lartësi prej 2014 m si pjesë përbërëse me majën e Peklenës. Për pushtimin e këtyre majave është e nevojshme që ti keni pajisjet e duhura të bjeshkatarisë.¹³

Fotografia e shtatë Alpinizmi



<https://kk.rks-gov.net/peje/ëp-content/uploads/sites/24/2018/04/aktivitetet-rekreative.pdf>

¹³ <https://kk.rks-gov.net/peje/ëp-content/uploads/sites/24/2018/04/aktivitetet-rekreative.pdf>

2.8. Paraglide

Aeronautika, ka një histori të begatshme dhe mjaftë të vjetër në qytetin tonë dhe njihet si një nga aktivitetet rekreative sportive e cila e ka një traditë të madhe. Të shumtë janë qytetarët të cilët janë marrë me këtë lloj aktiviteti, ndërsa tani ka marrë një hov më të madh zhvillimi i saj. Tani në qytetin e Pejës, janë dy baza kryesore ku adhuruesit e paraglides mund të zhvillojnë aktivitetin e tyre. Njëra gjendet në vendin e quajtur Maja e Zezë e cila ka lartësi mbi detare prej 900m dhe është shumë pozitive atraktive pasi që prej saj mund të shohësh gjithë qytetin e Pejës, e pothuajse edhe gjithë Dukagjinin, gjatë fluturimit, dhe tjetra gjendet në fshatin Lipë, në pjesën verie të Pejës, në drejtim nga ujëvara e Drinit të Bardh.¹⁴

¹⁴ <https://kk.rks-gov.net/peje/ep-content/uploads/sites/24/2018/04/aktivitetet-rekreative.pdf>

3. Merimangat e Pejës

Shoqata e alpinistëve "Merimangat e Pejës" është themeluar në vitin 2002, si iniciativë dhe bashkësi e intiresave të komunitetit të rinisë alpine në komunën e Pejës. Kjo shoqatë është edhe shoqata e parë e alipinstëve dhe më e madhja që vepron në Kosovë. Merimangat e Pejës sot është shumë active, dhe zhvillon projekte dhe aktivitete të ndryshme, të cilat kanë të bëjnë me rritjen e numrit të rrugëve të ngjitjes në shkëmb dhe promovimin e Pejës, si destinacion. Është gjithashtu aktive në zhvillimin e turizmit malor dhe aventurë, në këtë drejtim ka adminstruar projekte të ndryshme që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve njerëzore, të komunitetin lokal, kryesisht nëpërmjet trajnimeve të guidave, përmisimit të cilësisë së ofertave turistike dhe zhvillimit të infrastrukturës, si shtigje malore, rrugët e ngjitjes si dhe promovimi i Pejës, si një vend i destinacionit te turizmit aventuror. Projekti kryesor ndër të cila është ndërtimi i shtatë Via Ferratas në Kosovë, pesë urave Tibetiane dhe tri Zip Lines, shumica e të cilave si parazgjedhje e bëjnë këtë zonë një atraksion vërtetë unik për aventurat dhe kërkuesit e adrenalinës.¹⁵

¹⁵ <https://bnadventure.com/products/kosovo-tours/>

3.1. Via Ferrata (Shpellat)

Via Ferrata (Shpellat) kërkon kushte më të mira fizike, krahasuar me Arin dhe Matin. Pika e nisjes së ngjitjes është Ura e parë Tibetiane, nga ku gjysma e parë e rrugës ndahet me Via Ferrata Ari. Më pas për shpellat Via Ferrata dueni të vazhdoni djathtas, duke u ngjitur nëpër shkallët e vendosura në shkëmbinj, duke shijuar pamjet e bukura të Grykës së Rugovës. Është ndërtuar në vitin 2020, është shtegu 470 m i siguruar me litar metalik dhe kalon nëpër 7 hapje si në shpellë etj ku mund të ndalesh, të bësh foto, të pushosh përpara se të vazhdash segmentin tjetër. Për të përfunduar këtë Via Ferrata duhen 2 orë e 30 minuta deri në 3 orë.¹⁶

Fotografia e tetë Via Ferrat (Shpellat)



17

<https://ëëë.google.com/search?q=via+ferrata+shpellat&tbm=isch&ved=2ahUKEëiMv5yMëIP7AhUCnv0HHS-CCX AQ2>

18


¹⁶ <https://bnadventure.com/products/kosovo-tours/>

¹⁷ <https://ëëë.google.com/search?q=via+ferrata+shpellat&tbm=isch&ved=2ahUKEëiMv5yMëIP7AhUCnv0HHS-CCX AQ2->

cCegQIABAA&oq=via+ferra&gs_lcp=CgNpbËcQARgAMgQIIXAnMgQIIXAnMggIABCABBCxAzIFCAAQgAQyBQgAEIAEMgUIABCABDIFCAAQgAQyBQgAEIAEMgUIABCABDIFCAAQgAQ6BëgjEOoCECc6CAgAELEDEIMBOgcIABCABBA DOgsIABCABBCxAxCDAVCcH1j2PGCtTËgAcAB4A4ABmëGIAbkVkgEEMjluNpgBAKABAaoBC2d3cy13aXotaË1nsAE KëAEB&sclient=img&ei=SBhcY4z7GYK89u8Pr4SmgAc&bih=754&bië=1536#imgrc=IYeGJUZRqAxl_M

3.1.1. Via Ferrata Mat

Via Ferrata Mat, fillon të kalojë nëpër një shpellë të vogël artificiale dhe ngjitja shkon kryesisht horizontalisht mbi Lumin Lumbardhi gjatë gjithë kohës. Pika e nisjes së ngjitjes është pak para urës së parë rrugore. Via Ferrata është ndërtuar në vitin 2016, është një shteg 500 m i siguar që zgjat deri 1 orë e 30 minuta dhe përfundon në fillim të Via Ferrata Ari.¹⁸



https://ëëë.google.com/search?q=via+ferrata+mat&sxsrf=ALiCzsbneLjCG9Y4kËMp5eAKox6XRPFCIA:1670018005971&source=Inms&tbn=isch&sa=X&ved=2ahUKEëiZq47ë9dv7AhËËSfEDHar8DVvsQ_AUoAXoECAIQAë&bië=1536&bih=754&dpr=1.25#imgsrc=d5Ty6ËmFC1DmqM

19

3.1.2. Via Ferrata Ari

¹⁸ <https://bnadventure.com/products/kosovo-tours/>

¹⁹

https://ëëë.google.com/search?q=via+ferrata+mat&sxsrf=ALiCzsbneLjCG9Y4kËMp5eAKox6XRPFCIA:1670018005971&source=Inms&tbn=isch&sa=X&ved=2ahUKEëiZq47ë9dv7AhËËSfEDHar8DVvsQ_AUoAXoECAIQAë&bië=1536&bih=754&dpr=1.25#imgsrc=d5Ty6ËmFC1DmqM

Via Ferrata Ari, kalon nëpër disa shpella dhe ngjitet vertikalisht duke përfunduar me një pamje të bukur në majë të shkëmbinjëve të grykës. Pika e fillimit të ngjitjes është Ura e parë Tibetiane, dhe pjesa e parë e rrugës është ajo e përbashkët me shpellat Via Ferrata. Për Via Ferrata Ari, duhet të vazhdoni të ecni drejtë lart dhe për ta bërë këtë më të lehtë për ju, duhet të shihni edhe shenjën e drejtimit. Është ndërtuar në vitin 2013 dhe është një litar metalik i siguruar 450 m, i cili zgjat 1 orë e 30 minuta, për t'u ngjitur pastaj nga maja duhet të ecësh poshtë për 30 – 40 minuta për t'u kthyer në rrugën kryesore. Via Ferrata është produkti më i avancuar i aventurës në Kosovë. Për shkak të adrenalinës së tij të plotë, nuk nevojitet asnjë trajnim i mëparshëm. Rreth 90 % e klientëve tanë janë kohëmatës të parë. Por prapëseprapë zemra juaj do të rrahë ndërsa bëni ngjitjen vertikale përmes shkallëve metalike lart mbi Kanionin e Rugovës.²⁰

3.1.3. Via Ferrata Merimangat

²⁰ <https://bnadventure.com/products/kosovo-tours/>

Konsiderohet dhe kërkon përvojë të mëparshme. Pika e fillimit të kësaj Via Ferrata, është ura e dytë Tibetiane, në Grykën e Rugovës, e cila është 6 km larg qendrës së qytetit të Pejës dhe rreth 2 kilometra më larg se pikënisja e Urës së vogël Tibetiane. Via Ferrata ka përfunduar në vitin 2019, është 1 km e gjatë dhe rreth 3 orë do të gjeni veten duke ngjitur shkallët e fiksuara në shkëmbinj dhe do të shijoni shpërthimet e adrenalinit dhe pamjet e mrekullueshme të Kanionit të Rugovës. Për ata që nuk kanë dëshirë të shkojnë deri në fund, ata mund të marrin një dalje të sigurtë në gjysmë të rrugës dhe të ecin deri në pikën e përfundimit.²¹

²¹ <https://bnadventure.com/products/kosovo-tours/>

4. Ura e madhe Tibetiane

Ura e madhe tibetiane ndodhet në lartësi 60 m dhe gjatësia e saj prej 40 m lidhet nga të dy anët e Grykës së Rugovës, duke shërbyer edhe si pikënisje e Via Ferrata Merimangat. Është ura më tërheqëse në Kosovë dhe unike në llojin e saj. Për ata që nuk ndihen të trullosur, mesi i urës është vendi i duhur për të admiruar një pamje të bukur panoramike.²²

²² <https://bnadventure.com/products/kosovo-tours/>

5. Zip line

Zip line duke fluturuar si shqiponjë për 650 m për rreth një minutë, do t'ju japë pamjen më të mirë mbi Kanionin e Rugovës. Zip Line është produkt i turizmit të aventurës, i cili ka krijuar lidhje të mirë ndërmjet Via Ferrata Merimangat, dhe tre të tjerave, të vendosura në anën tjetër të grykës, duke mundësuar të kaloni 5 km të Grykës së Rugovës vetëm në ajër. Ky është i vetmi Zip Line, i madh në Kosovë, dhe është çertifikuar nga një Organizatë Ndërkombëtare. Zip Line përdor paisje të prodhuara nga SHBA dhe staf profesional të trajnuar. Është zona e re e ngjitjes në shkëmbinjtë e njohur “ Vip-Balcony”, e cila në përbërjen e saj ka 15 vija të reja të ngjitjes të cilat do t’ju ofrohen vizitorëve. Nëse jeni në Kosovë kjo është një nga aktivitetet e detyrueshme me një çmim prej 10 euro. Zip Line hapet çdo ditë pune përveç të hënës nga ora 14:00 deri në orën 19:00. Në Fundjavë hapet në orën 12:00. Në një kohë me shi, Zip Line nuk funksionon, gjithmonë mund ta konfirmoni duke na telefonuar. Provoni këtë aventurë kur tëvizitoni Kosovën. Kombinoje atë me një Udhëtim Via Ferrata.²³

Vip-Balcony

Në mesin e kësaj natyre të bukur, unikalitet të veçantë në Grykë të Rugovës paraqesin edhe tunelet. Burimi në Grykën e Rugovës gjendet në kilometrin e pestë, ku do të freskoheni dhe do të përjetoni kënaqësi të paharrushme.

²³ <https://bnadventure.com/products/kosovo-tours/>

6. Veçoritë themelore dhe zhvillimi i marketingut të udhëtimeve turistike

Me këtë kemi të bëjmë me kuptimin e marketingut modern, ashtu siç është aplikuar ndërkombëtarisht për mallëra dhe shërbime të të gjitha llojeve, por edhe shërbimet në turizëm. Qëllimi është që të përcaktojë veçoritë esenciale të përbashkëta për të gjitha format e marketingut. Për të kuptuar marketingun, është e nevojshme të bëhet dallimi në mes të fjalës së njohur në përdorim të përgjithshëm dhe afatëgjatë, siç është përdorur në mënyrë profesionale nga menaxherët e marketingut. Shumë agjensi turistike bëjnë promovimin e ofertave turistike në të katër anët e rruzullit tokësor. Marketingu është në qasje për zhvillimin e biznesit në shekullin XX dhe në tregjet e lira. Zhvillimi i marketingut është bërë i domosdoshëm në dekadat e fundit të shekullit XX dhe fillimin e shekullit XXI. Shumë vende të ish – bllokut socialist filluan të japin rëndësi procesit të marketingut. Qëllimi i orientimit të marketingut bëhet për të pas ma te qartë se çfarë orientimi duhet të ketë marketingu në drejtim të qëndrimit të menaxhimit. Të gjitha këto qojnë në disa përkufizime formale, prej të

cilave pesë janë nxjerrë. Më e rëndësishmja është se marketingu është një sistem i përbërë nga një numër i fazave, përmes të cilave rriten qarkullimet turistike.²⁴

24

6.1. Definimi i marketingut

Gjatë zhvillimit të marketingut, autorët e ndryshëm kanë kontribuar lidhur me definimin se çka paraqet marketingu. Nga këto dalin rezultate të ndryshme dhe teori të ndryshme nga autorët e ndryshëm. Për të pas paraqitje pozitive, jepen mendime të ndryshme lidhur me definimin e marketingut. Definicioni më i shpeshtë, i cili haset gjatë shfletimit të literaturës është i F. Kotler, i cili njëkohësisht ka punuar në zhvillimin e marketingut në degët botërore. Sipas tij: "Marketingu është analizë, organizim, planifikim, dhe kontroll i burimeve orientale ndaj blerësit, politika dhe aktiviteti në pikëpamje që ti kënaq nevojat edhe dëshirat e blerësve, gjatë punës rentabile". F. Rroko, marketingun e kupton si sistem për të cilin thotë: "Në bazë të mënyrës së cilës ky sistem ëshë formuar, shfrytëzuesi është pikë kuqe e marketingut. Ai gjendet jashtë ndërmarrjes...". Kjo marëdhënie ndërmjet shfrytëzuesit dhe prodhuesit (përkatësisht kërkuesit dhe ofertuesit) zhvillohet në degët e sistemit ekonomik shoqëror.²⁵

²⁴ F. Reçica, B. Millaku "Marketingu i udhëtimeve turistike" Fq.15 Prishtinë, 2012

²⁵ F. Reçica, B. Millaku "Marketingu i udhëtimeve turistike" Fq.16 Prishtinë, 2012

6.2. Zhvillimi i marketingut

Fjala Marketing ka filluar të përdoret që nga viti 1904 dhe 1905 në Universitetin e Pensilvanisë, gjatë një ligjërata.

"Marketing" do të thotë shkëmbime në aspektin e kërkesës dhe ofertës në një treg të përgjithshëm. Marketingu mund të shpjegohet si proces i arritjes së shkëmbimeve vullnetare, në mes të dy palëve, ku:

1. Konsumatorët zgjedhin të blejnë ose të përdorin produkte;
2. Organizatat prodhuese, bëjnë furnizimin dhe shitjen e produkteve;

Në kushtet e konsumatorëve, marketingu ka të bëjë me:

1. Kuptimin e nevojave dhe dëshirave të bleërësit ekzistues dhe të ardhshëm ;
2. Cilat prodhime ata zgjedhin, kur, sa, me çfarë çmimi dhe sa shpesh;
3. Si ata marrin informacion në lidhje me ofertën e produktit;
4. Kur ata të blejnë produkte, në mënyrën (direktë ose nëpërmjet një ndërmjetësi të shitjes me pakicë);
5. Si ata të ndjehen pas blerjes së tyre, kur i konsumojnë produktet;

Në kushtet e prodhuesve, marketingu në atë se:

1. Cilat produkte duhet prodhuar dhe pse, veçanërisht produktet e reja;

2. Sa duhet prodhuar produkte në sasi për vëllimin e furnizimit;
3. Në çfarë çmimi;
4. Mënyrën se si ka për të komunikuar ofertat e tyre, me cilat media.²⁶ⁱ

26

7. Kuptimi i agjensive turistike

TURIZMI – është një grup i mardhënieve dhe fenomenet që rrjedhin nga udhëtimi dhe që qëndrojnë në një vend dhe se një qëndrim i tillë nuk është i bazuar në vendbanim të përhershëm. TURISTI – është personi, i cili e lëshon vendin e qëndrimit të përhershëm, i cili shkon në vendin tjetër për motive të pushimit dhe rekreacionit. Në fillim të zhvillimit të turizmit, turistët kishin nevojë për organizimin e transportit dhe rezervimin e akomodimit dhe nevojat, duke përfshirë edhe nevojat e tjera. Me përfshirjen në rritje të masave të popullsisë në turizëm agjensitë e udhëtimit paraqiten si domosdoshmëri midis turistëve dhe ofruesve të shërbimeve turistike në anën tjetër. Agjensitë e udhëtimit kanë ndërmjetësuar në mes të kërkesës turistike, në njërën anë dhe ofertës turistike. Agjensitë turistike janë ndërmarrje në fushën e ndërmjetësimit, të cilat aktivitet kryesor kanë organizimin e udhëtimit, duke përfshirë amkomodimin dhe shërbimet tjera në destinacionin turistik.²⁷

²⁶ F. Reçica, B. Millaku "Marketingu i udhëtimeve turistike" Fq. 22 Prishtinë , 2012

E cituar nga: A.W.Frey. Marketing, Handbook, The Ronald Press Co, New York, 1965, fq.1.4 – 1.5

²⁷ F. Reçica, B. Millaku, Sh. Nallbani "Agjensitë turistike Fq.20 Pejë, 2013

P. Gradjan Turisticke Agencie i turoperatorifq.8

8. Lugina e Rugovës

Një nga pikat kryesore të natyrës së Ballkanit është Lugina Kosovare e Rugovës. Një varg malor i shtrirë me ujëra, ujëvara dhe shkëmbinjë. Ju mund ta vizitoni këtë park falas. Ata që duan lirishtë të shijojnë zonën mund të kalojnë nëpër luginë me makinë, çdo stinë sjell një tjetër bukurie, ndaj ka mjaftë për t'u shijuar. Dëshironi të bëni një shetitje? Thjesht parkoni makinën tuaj përgjatë rrugës në një vend të rëndësishëm dhe merrni një nga shtigjet e shumta anësore. Dy shkolla skijimi janë të vendosura atje. Bogë është gjithashtu një vend i këndshëm për të marrë një qira një shtëpi prej druri për një ose dy ditë, si në dimër ashtu edhe në verë.²⁸

²⁸ <https://ëëë.kosovo-info.com/kosovo-tourism/rugova-valley/>

10. Vështrim në konceptet e teorike të interpretimit të historisë dhe të trashigimisë kulturore

Në fushën e trashigimisë kulturore "interpretimi është proces i komunikimit i dizajnuar për të nxjerrë në dritë kuptimin dhe marrëdhëniet e trashigimisë kulturore dhe natyrore, nëpërmjet ndërveprimit me objekte, artifakte, peisazhe dhe lokalitete." Edhe pse shumë konciz dhe i lehtë për t'u kuptuar, interpretimi i këtij përkufizimi në vetvete ka një implikim kur bëjmë dallimin midis trashigimisë "sonë" kulturore apo natyrore apo natyrore si të ndryshme nga ajo e "të tjerëve". Interpretimi i historisë, në anën tjetër, është një çështje që është rikthyer në fokus të diskutimeve teorike në fund të viteve 1980-ta në Evropë, si rezultat i kalimit të vendeve të bllokut lindor nga komunizmi sovjetik në demokracinë perëndimore. Një nacionalizëm kulturor dhe etnik, mjaftë kompleks dhe konfliktuoz, u shpërfaq menjëherë pas shpërbërjes së ish - Jugosllavisë dhe u shqua për përdorimin e trashigimisë kulturore si mjet lufteve dhe paqeje. Shembulli më i theksuar dhe i fundit në këtë kontekst është pretendimi serb në rastin e Kosovës.²⁹

10.1. Interpretimi i historisë

Interpretimi i historisë konsiderohet të një nocion i thjeshtë dhe vetë - shpjegues; përkatësisht, interpretimi historik pritet të jetë shpjegim i thjeshtë i ngjarjeve historike, subjekteve apo vendeve a lokaliteteve historike. Megjithatë, interpretimi historik më shpesh i referohet procesit në të cilin historia paraqitet duke theksuar ngjarjet më karakteristike dhe të

²⁹ Pjesë të përmbajtjes së kësaj kapitule janë publikuar si artikull me titullin: Florina Jerliu: Historia dhe trashigimia kulturore e Kosovës në kontekstin shtetformues – Çështje të interpretimit bashkëkohor. Studime Shoqërore 3, ASHAK, 2016, ff.183-204

Veverka J. What is interpretation. An overview of Interpretive Philosophy and Principles.

rëndësishme të së kaluarës historike.³⁰ Interpretime të tilla në Shtetet e Ballkanit janë të sojit të nacionalizimit që kanë tendencë të instrumentalizmin e trashëgimisë kulturore dhe vashdimësinë etnike të popullsisë.³¹ Krijimi i këtij komogjeniteti sipas sociologut Victor Roudometof është i frymëzuar nga praktika otomane e dhënies së të drejtave kolektive anëtarëve të një shoqërie fetare (Rum millet) duke bërë që kriteret partikulariste të marrin rolin udhëheqës mbi ato universale, të cilat do të jenë të dukshme më vonë në demokracitë perëndimore. Si rezultat i kësaj, përkatësia në shtetin kombëtar njehësohej me përkatësinë në një komb, i definuar më tej në kuptimin etnik dhe fetar.³²

11. Evoluimi i turizmit

Turizmi nuk ka lindur me qytetrimin industrial apo me zhvillimin e industrive. Turizmi ka perparuar ne lidhje te ngushte me evoluimin e njerezimit dhe te qytetimit te tij. Ai është një fenomen që zhvillohet paralelisht me hostrinë dhe progresin e njerëzimit. Është e rëndësishme të theksohet se turizmi edhe në periudhat e ekspansionit të tij më të madh nuk ka arritur një formë kaq e gjere dhe të zhvilluar Në ditët e sotme turizmi është zhvilluar aq shumë sa sot me të drejtë flasim për dimensione ndërkombëtare të tij. Në shekullin XVII në Francë filloi të përdoret për herë të parë fjala "Grand Tour" e cila një shekull më vonë hyri në të foluren angleze. Këtu e ka zanafillen dhe fjala turizëm dhe turist. Pëfundimisht, mund të theksojmë që gjatë këtyre shekujve, deri në prag të shekullit XIX turizmi ishte i lidhur kryesisht me faktorin kulturor dhe edukativ. Ai ishte i kufizuar kryesisht në një numer të pakët njerëzisht, me shumë të shtresave aristokrate që i kishin mjetet, mundësitë dhe kohen për kryerjen e këtyre udhëtimeve.

në traditat e popujve si në këtë epokë.

³⁰ Goldstein. L. J. (1975). A note on hostirolcal interpretation, Philosophy of Sience, f. 313.

³¹ Roudometof, V. (1996). Nationalism and Identity..., ff, 253 – 301.

³² Roudometof, V. (2002). Collective Memory, national identity, and ethnic conflict: Greece, Bulgaria , and the Macedonian question ., f.18 - 19

12. Perfundimi

Gjatë kësaj teme kemi kuptuar se Rugova e ka pak të zhvilluar turizmin, se nuk ka shumë zona të investuar, nuk ka infrastruktur të duhur por pavarësisht kësaj se kemi pak potenciale ekonomike për turizëm kemi shumë zona që vizitohen dhe janë të frekuentuara prej banorëve vendas dhe turistëve të huaj. Zhvillimi i turizmit në Rugovë në këtë zonë turizmi është i fokusuar në krijimin e akomodimeve të pavarura me fjetje dhe mëngjes, ku vizitorët do të kenë mundësi të jenë në kontakt me banorët, me stilin e jetës dhe me kuzhinën lokale.

Mundësitë rekreative në lidhje me këtë formë të akomodimit fokusohen në qasjen në shtigjet për ecje që çojnë në Majën e Hajles, e cila shënon kufurin mes Kosovës dhe malit të Zi. Megjithatë, infrastruktura dhe qasja në vendet që ofrojnë këto mundësi është e dobët, ku në shumë vende rrugët kanë më shumë karakterin e shtigjeve, duke e kufizuar qasjen e grupeve të vizitorëve dhe të tjerëve të cilët më më qejf do të vizitonin vendet me qasje më të lehtë dhe me kapacitete për të mirëpritur grupe më të mëdha. "Resurset natyrore të bjeshkëve të Rugovës determinojnë funksionimin rekreativ dhe ekonomik të tyre, ekologjia e strukturave natyrore mund të merret si bazë e shëndoshë për zgjerimin cilësor dhe sasior të atraktivitetit që janë në funksion të turizmit dhe për mbajtjen dhe përparimin e këtij mjedisi natyror. Vetëm përmes turizmit dhe në sajë të saj mund të realizohen mjetet e nevojshme për mbrojtje".

10. Referencat

1. <https://kk.rks-gov.net/peje/turizmi/>
4. <https://m.facebook.com/nt/screen/?>
3. Reçica, Fetah & Millaku, Bedri "Hyrje në turizëm dhe hotelieri" Prishtinë, 2014
4. <https://bnadventure.com/products/kosovo-tours/>
5. Reçica, Fetah & Millaku, Bedri "Marketingu i udhëtimeve turistike" Prishtinë, 2012
6. Reçica, Fetah & Millaku, Bedri & Nallbani, Shqiponja "Agjensitë turistike" Pejë, 2013
7. <https://ëëë.kosovo-info.com/kosovo-tourism/rugova-valley/>

8.Mihal Duri, Vila “Odette”, Nr.1, Tiranë – Albania.